Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**17.11.2023**	**21.11.2023**	**2023/0848**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 29.10.2023, OE “"KRASNIQI"SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0848, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “"KRASNIQI"SH.P.K.”- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Pastrimi i Hapsirave te brendeshme, te Objekteve ne QKUK-e” me nr. të prokurimit: "701-23-10641-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0848 i dt:29.10.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 Qëllimi,

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës.

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës,

Neni 69 Aftësitë teknike dhe profesionale.

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse te Rregullore Nr.001_2022 për prokurimin publik si dhe të A02_Udhezues Nr-001_2023 për prokurimin publik qe kane te bëjnë me Kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë

Te pa kënaqur me vendimin e AK-së datës 26.10.2023 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e Kërkesës për Ri-shqyrtim Qendra Klinike Universitare e Kosovës

ne lidhje me aktivitetin e prokurimit:

Pastrimi i Hapsirave të brendëshme të Objekteve në QKUK-ë me nr. te prokurimit: 701-23-10641-2-1-1dhe Nr. i brendshëm: Nr prokurimit brendshëm 701-23-211-211:

ANKESË

Pretendimi 1.

Kerkesa mbi mundesin teknike dhe profesionale pika 9.1 dhe 9.2

1.Te kerkesa nr.3

AK ka kerkuar që Operatori Ekonomik duhet të ketë një staf profesional si dhe të ketë përvoj në sherbimet adekuate shkollore, së paku një puntorë të kualifikuar për sanitari apo diqka të ngjajshme.

Pergjigja nga AK për këtë pyetje ka qenë: referohuni dosjes së tenderit.

Të pa këaqur me përgjigjen e AK-së në sqarimin e pyetjeve, pasi që ne, i'u kemi drejtuar AK me Kërkesë për Rishqyrtim, ku AK në vendimin e datës 26.10.2023 është përgjigjur:.

Përgjigja e AK-se lidhur me Pretendimin 1 është:

Ky pretendim i OE është i pabazuar sepse Autoriteti Kontraktues ka kontrolla nga institucione të tjera rekevante që merren me kushtet e hixhienës në objektet e QKUK-së (Inspektor sanitar) andaj OE ofertues duhet të ketë së paku një punëtorë të kualifikuar për sanitari apo diqka të ngjashme.

Mirëpo, pas përgjigjës që kemi marrë nga Autoriteti Kontraktues, prap se prap AK insiston në këtë kërkesë, e cila nuk ka të bëjë fare më këtë aktivitet të prokurimit sepse edhe një herë po e potencojme se askund në këtë dosjë të këti aktiviteti nuk është kërkuar

mirëmbajtja e sanitarise por vetëm pastrimi i hapsirave të brendshme

Kjo kërkesë është e panevojshme dhe është në kundërshtim me këtë aktivitet të prokurimit sepse këtu kemi të bëjmë vetëm me pastrimin e siperfaqeve të brenshmë në objeket e QKUK-së dhe askund në dosje të tenderit nuk shkruan se ne do të mirmbajm edhe sanitaritë, sepse QKUK-ja i ka puntorët për sanitari dhe punë të tjera. Kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 69 te LPP-se, pasi qe vet natyra e këtij aktiviteti te prokurimit është pastrim i hapësirave të brendshme dhe në asnjë pozicion në paramase te këtij aktiviteti nuk është rregullimi i sanitarisë, por vetëm pastrimi i tyre.

Kjo është një kërkesë e kundërligjshme te cilën AK duhet ta heq nga DT dhe NJK pasi qe nuk ka të bëjë fare me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit konform nenit 25.6 te Rregullores Nr.01/2022 te KRPP-së ku thuhet: Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.

Pretendimi 2.

AK ka kërkuar edhe ISO standrdet si

1. Kërkesa 4. OE të jetë i certifikuar me ISO 9001 2015 – Menaxhimi i Cilësisë për shërbimet e Higjienës
2. Kërkesa 5. OE të jetë i certifikuar me ISO 14001 2015 – Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit për shërbimet e Higjienës
3. Kërkesa 6. OE të jetë i certifikuar me 45001 2018 Sistemi i menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë për shërbimet e pastrimit

Përgjigja e AK për pretendimin nr2:

Ky pretendim i OE është i pa bazuar sepse kemi te bejme me pastrmin e objekteve ku ndjeshmeria ështe shumë e lartë dhe lidhet direkt edhe me pacientin andaj AK kërkon nga Operatorët ekonomik qe të kenë një Menagjim profesional ku lidhet direktë me shërbimin e cilesis për shërbimet e higjinës, një Menaxhim profesional ku lidhet direkt me mjedisin sepse kemi të bëjme me largimin e mbeturinave të

produkteve medicinale, një Menagjim profesional ku lidhet direktë me sigurinë në punë për të gjithë punëtorët e angazhuar nga OE sepse kemi të bëjmë me pastrimin e hapësirave me rrezikshmëri të lartë nga smundjet e ndryshme qe trajtohen pacient nëpër klinika.

Sa i përket menaxhimit të mbeturinave medicinale, OE për pastrim te brendshem, nuk merret me menaxhimin e tyre, pasi që Autoriteti Kontraktues ka njësine e posaqme të infiermierise dhe shërbimeve teknike për trajtimin e mbeturinave medicinale. Më pas po e theksojmë se në këtë aktivitet të prokurimit nuk kemi të bejme me mjedis, pasi që ky aktivitet i dedikohet pastrimit të sipërfaqeve të brendshme.

Kërkesat e Autoritetit Kontraktues sa janë disktriminuese për OE, më tepër janë favorizuese për OE të caktuar, kritere të tilla shpërfaqin monopol në treg dhe krijojnë pasiguri për pjesëmarrjë sa më të gjerë të Operatorëve Ekonomik të interesuar.

Kjo kërkesë, nuk është se garnaton ndnjë standard në fushën e aktivitetit të pastrimit, por vetëm ngarkesë shpenzuese për OE.

Ne mendojme se këto ISO standarte janë të pa nevojshme,

Pra kjo kërkesë është në kundershtim me ligjin dhe si e tillë duhet të largohet nga kriteret e përzgjedhjes.

Lidhur me këtë pretendim kemi vendimin e OSHP-së të datës 15.12.2022 me numër të protokolit 664/22, ku për të njëjtin kriter një OE është ankuar dhe të njëjit i është aprovuar ankesa.

Provë, Linku ku mund ta gjeni vendimin:

https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Search?

__RequestVerificationToken=GRz0iMzë2PQrmy6ihKDKgmPD0TIYcSbbCYBakEe5Am

07xeejEjBISëbEGQmhAvmTh467oJvpSZËrKTJ78ltZpYMGfRAZL-ik-qeElxËKo1&ProcurementNumber=&ContractingAuthorityId=97&EconomicOperatorId=

Pretendimi 3.

Kërkesa 5. OE ka për obligim të angazhoi të gjithë puntorët në shërbimet e pastrimit

në muajt e fundit në QKUK. Kjo kërkesë është diskriminuese sipas neni 7 LPP-së pasi

që AK nuk ka të drejtë të obligoj (imponoj) OE marrjen e këtyre punëtorëve. Pra edhe kjo

kërkesë është e pa nëvojshme dhe duhet të largohet.

Përgjigja nga AK:

Ky pretendim i OE është i pabazuar sepse të gjithë punëtorët e pastrimit kan qenë

ma herët pjesë e QKUK-së dhe në momentin e kalimit të shërbimit të pastrimit te

operatoret privat në të gjitha kontratat e mëhershme me operator ekonomik të

ndryshëm qe kan qen të kontraktuar nga QKUK-ja kan qen të angazhuar.

Kjo kërkesë nuk ka qenë asnjëhere obligative në procedurat e mëparshme ashtu siç

pretendon AK.

Shtrohet pyetja, se në baze të cilës dispozitë ligjore, Autoriteti Kontraktues obligon OE-në

që ti pranoj punëtorët aktual. Pra kjo kërkesë është diskriminuese dhe njëkohësisht

favorizuese për një OE të caktuar, sipas neint 7 të LPP-së.

Pretendimi 4.

Edhe për këtë kërkesë AK nuk ka dhënë sqarime në pyetjet e parashtruara për sqarime

shtesë. Pergjigja e AK ka qenë:

Referohuni dosjes së tenderit.

Te pika 9.1 dhe 9.2 te kerkesa per kapacitete teknike dhe profesionale njoftimi per kontrat

Pse është hequr kërkesa dhe dëshmia, te cilat po i paraqesim ne vijim :

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1. Kërkesa 1. Operatori Ekonomik ofertues duhetë ofrojë një listë te kontratave te natyrës sengjashme (lëmin e pastrimit) te përfunduar me sukses ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë.	**Evidenca 1. Operatori Ekonomik ofert duhet të ofrojë dëshmi një listë te kont natyrës se ngjashme (lëmin e pastrimit përfunduar me sukses ne tri vitet e shk data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te percjellur me referenca ap raporte te pranimit. Lista duhet ti per dhenat si Daten e nenshkrimit, Daten perfundimit, Titullin e Kontrates, Aut Kontraktues, Vleren e projektit.**

AK e ka larguar kete kerkese në NJK, në kundërshtim me LPP-në, Pra AK duhet te veproj konform LPP-se pika 4 dhe 4.2 e Nenit 69 tek, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale ku thuhet se:

4. Në procedurat që shpien në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve; në veçanti, të dhënat mund të kërkohen lidhur me shkathtësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë. Të dhënat përkitazi me aftësitë teknike të operatorëve ekonomik mund të parashtrohen përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të shërbimeve që duhet të furnizohen:

4.2 listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkënënshkrura nga autoriteti i tillë publik: (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të

nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë;

Krasniqi SHPK <shpk.krasniqi@gmail.com>
To: Besa Kurti <Besa.Kurti@atk-ks.org>

Pershndetje

E nderuara Besa Kurti

ne kemi komunikuar me zyrtaret te ATK-se te regjionit ku jemi si tatimpagues dhe ata kan thene se nuk leshojme as
pastrimit te brendshem ne tri vitet e fundit .
ne leshojm vetem vertetime se a ka borgje apo nuk ka borgje OE dhe per pune te tjera si viza apo diqka te ngjajshm
Per ate arsyeje ju kemi drejtuar juve si zyre ligjore se a leshon ATK vertetim tatimor siq e ka kerkuar Autoriteti Kontr
Hapsirave të brendëshme, të Objekteve në QKUK-ë me nr të prokurimit 701-23-10641-2-1-1, Nr i bre

https://mail.google.com/mail/u/0/?ik=989507a36e&view=pt&search=all&permthid=thread-a:r2788194923175140351&dsqt=1&simpl=msg-a:r16694

10/28/23, 5:32 PM Gmail - Pyetje për ATK

Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar me një vlerë të përgjith të brendshëm për tre vitet e fundit

Evidenca 1. OE duhet të ofroj si dëshmi vërtetimin tatimore për qarkullim në lëmin e pastrimi ATK për vitin 2020, 2021, 2022) prej jo më pakë se 4,000,000.00 euro

JU lutem te na e ktheni pergjigjie.

Faleminderit

Me respekt!

ky veprim i AK është edhe ne kundërshtim me nenin 25.5 te Rregullores Nr.01/2022 te KRPP-së ku thuhet: "Kriteret e përzgjedhjes do të specifikohen qartë në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit",

Pra AK është dashur qe te kërkoj një liste te kontratave sipas pikës 4.2 te nenit 69 te LPPse pasi qe është patjetër e nevojshme qe te dihet se ku janë kryer ato pastrime te brendshme, kur kane filluar dhe kur janë kryer apo nuk janë kryer me sukses etj.

Pra AK po bie ne kundërshtim me vetveten pasi qe vet AK ka kërkuar qarkullim ne vlere prej 4,000,000 € ne lëmin e pastrimit te brendshëm kurse nuk ka kërkuar asnjë dëshmi se si mund ta vërtetoj nje OE pjesëmarrës ne këtë procedure qe ai qarkullim prej katër milion euro qe e prezanton ka rrjedh nga lemia e pastrimit te brendshëm

Ky është kriteri kryesor i cili dëshmon per kapacitete teknike dhe profesionale te OE. Keni

kerkuar qarkullim prej 4,000,000.00 euro ne lemin e pastrimit te brendshem dhe me qka te deshmohet.

Ky qarkullim nuk mund te deshmohet (vertetohet) me vertetim tatimor apo me deklarat tatimore nga ATK. kemi bere pyetje ATK-se lidhur me kete qeshtje te qarkullimit , vertetim tatimor ose deklarat tatimore. Pergjigjien gojore qe e kemi pranuar nga ATK-ja Ka qene sepse ATK nuk leshon kurrfar vertetimi tatimor me qarkullim per periudha te caktuara siq keni kerkuar ne dosje te tenderit, mirepo leshon vetem deklarat tatimore vjetore ose mujore per qarkullim per ate periudhe per tri vitet e fundit ashtu siq eshte kerkuar ne DT por kurrsesi nuk e specifikon se qarkullimi eshte ne lemin e pastrimit te brendshem apo ndonje lemi tjeter. Por, ky qarkullim vertetohet vetem me kontrata te realizuara (perfunduara) duke ju bashkangjitur referencat ose raportet e punes, shumen e kontrates, daten e fillimit dhe te mbarimit te kontrates ashtu siq e parasheh ligji dhe ashtu siq e keni kerkuar ne njoftimin per kontrat. Pra, me heqjen e kesaj kerkese duket qarte se AK është percaktuar për favorizimin e një kompanie për të cilën jemi në dijeni edhe ne si OE.

Ne vend se te vendosni kritere komform peshes se ketij atktiviteti te prokurimit ne vlere mbi 7,000,000.00 euro, AK ka vendosur kritere diskriminuese dhe favorizuese, e themi me plote pergjegjesi Kritere Favorizuese eshte se e keni hequr ne njoftim per kontrata kerkesen mbi mundesin teknike dhe profesionale.

Mos vendosja e kësaj kërkese iu jep mundësi edhe shumë operatoreve ekonomik të tjere të konkurrojnë pa kurrfarë përvoje në këtë proces, pra iu jepet mundësia që të konkurrojnë edhe kompanit e ndërtimit të rrugëve, pastrimit kimik, pasrimit te rrugeve, kompanive të ndërtimit të ndërtesave dhe shume kompani të tjera , të cilat nuk janë të profesionalizuara për këtë lëmi.

Përgjigja nga AK:

Ky pretendim i OE është i pabazuar sepse AK mendon se deshmia me e mirë qe prezentohet nga një Operator ekonomik profasional në lëmin e pastrimit është

qarkullim prej 4,000,000.00 në lëmin e pastrimit të brendshëm. Ky qarkullim mund të dëshmohet (vërtetohet) me vertetim tatimor apo me deklarat tatimore nga ATK. Autoriteti Kontraktues, në lidhje me këtë kërkesë, mendon dhe vepron në mënyrë arbitrare, sepse nuk mbështetet në asnjë dispozitë ligjore, por jep vetëm përgjigjë subjektive ashtu siç i konvenon për të favorizuar një OE të caktuar, kurse Institucioni kompetent ATK, jep përgjigje dhe interpretim ligjor lidhur me këtë kërkesë, i cili e hedh poshtë përgjigjen e AK-së që ky qarkullim dëshmohet me vërtetim tatimorë ose me deklarate sepse ATK ka informacione vetëm mbi qarkullimin e përgjithshëm të një tatim paguesi por nuk ka qarkullim të një tatim paguesi për një lëmi të caktuar, ashtu siq ka kërkuar AK (pastrim i brendshem).

Pra dëshmi e cila e vërteton qarkullimin në lëmin e pastrimit të brendshem është lista e kontratave të natyrës së ngjashme(lëmin e pastrimit) të përfunduara me sukses në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë, të përcjellur me kopje të kontratave duke i bashkangjiur referencat apo raportet e punës. Lista duhet ti përmbajë të dhënat si: Datën e fillimit dhë të mbarimit të kontratës, titullin e kontratës, Autoritetin Kontraktues dhe vlerën e projektit.

Autoriteti Kontraktues e ka larkuar këtë kriter nga DT dhe NJK për të favorizuar një

Operator Ekonomik.

Pra siç shihet qartë në vendim, Autoriteti Kontraktues, nuk është bazuar në asnjë ligj të prokurimit, mirepo jep mendime sipas dëshirës.

Provë: Po i bashkangjesim komunikimet përmes e-mailit me ATK-në lidhur me këtë

kërkesë.

10/28/23, 5:34 PM

Gmail - Pyetje për ATK

Siç edhe ju informova ju duhet te drejtohuni ne zyrën e Shërbimit dhe Edukimit të Tatimpaguesve në Regjionin të cilit i përkisi
ka informata mbi qarkullimin e përgjithshëm të një tatimpaguesi, por nuk ka qarkullim te një tatimpaguesi per një lëmi te ca

Për çdo informatë shtese mund te na kontaktoni ne numrin e telefonit 038/200 250 17

Me respekt,

Besa Kurti
Udhëheqës i Divizionit
Dep. Regji. dhe Shërb. të Tatimpaguesve - Div.Shërb. të Tatimpaguesve
Prishtinë - Drejtoria e Përgjithshme

Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Tel: +383 38 200 250 17
Fax: +383 38 200 250 07
Mobile: +383 44 234 469
Ueb: www.atk-ks.org

Kërkojmë nga OSHP që ta detyroj AK-në të përpiloj dosjen e tenderit konform dispozitave te LPP-se dhe Rregulloreve Nr.001_2022 për prokurimin publik si dhe të A02_Udhezues Nr-001_2023 për prokurimin publik që të kemi mundësi të ofertojmë në

këtë aktivitet të prokurimit pasi që kërkesat e vendosura nga AK nuk janë konform LPP-se dhe legjislacionit sekondar te KRPP-se e jo në kundërshtim me to, dhe te nxjerr;

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik Krasniqi shpk Lidhur me aktivitetin e prokurimit: Pastrimi i Hapsirave të brendëshme të Objekteve në QKUKë me nr. te prokurimit: 701-23-10641-2-1-1

II. NDRYSHOHEN kërkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktues në njoftimin per kontrate dhe ne dosje te tenderit dhe AK do te veproj konform nenit 53 te LPP-së. Lidhur me aktivitetin e prokurimit: Pastrimi i Hapsirave të brendëshme të Objekteve në QKUK-ë me nr. te prokurimit: 701-23-10641-2-1-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Qendra Klinike Universitare e Kosovës.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP).	**Evidenca 1. Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit QKUK ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të QKUK, për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor të përmendur, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet, do ti konfiskohet garancioni i sigurimit te ofertës dhe QKUK do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në rang-listë. Dokumentet te cilat do te kërkohen si dështmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon a.Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. (origjinali ose kopja e noterizuar) Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]. (kopje).**
Përshtatshmëria profesionale:	*Dështmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1. Certifikatë e regjistrimit të biznesit , regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.	**Evidenca 1. Te dështmohet me Certifikatë te Regjistrimit te Biznesit si dhe me informacione te biznesit-Kopje**
Kërkesa 2. Certifikatë e numrit fiskal.	**Evidenca 2. Te dështmohet me Certifikatë te Numrit Fiskal- Kopje**
Kërkesa 3. Certifikatë e TVSh-së.	**Evidenca 3. Te dështmohet me Certifikatë te TVSh-së Kopje.**
Kërkesa 4. OE të jetë i certifikuar me ISO 9001 2015 – Menaxhimi i Cilësisë për shërbimet e Higjienës	**Evidenca 4. OE duhet të dështmoj kopje të certifikatës ISO 9001-2015 të akredituar në Menaxhim të Cilësisë për shërbimet e Higjienës**
Kërkesa 5. OE të jetë i certifikuar me ISO 14001 2015 – Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit për shërbimet e Higjienës	**Evidenca 5. OE duhet të dështmoj kopje të certifikatës ISO 14001-2015 më akreditim në Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit për shërbimet e Higjienës**

Kërkesa 6. OE të jetë i certifikuar me 45001 2018 Sistemi i menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë për shërbimet e pastrimit	**Evidenca 6. OE duhet të dëshmoj kopje të certifikatës ISO 45001 2018, më akreditim në Sistemi i menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë për shërbimet e Higjienës**
Kapaciteti ekonomik dhe financiar: **Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 4,000,000.00€, në lëmin e pastrimit të brendshëm apo te ngjashme për tre vitet e fundit**	**Dëshmia e kërkuar dokumentare:** **Evidenca 1. OE duhet të ofroj si dëshmi vërtetimin tatimore për qarkullim në lëmin e pastrimit të brendshëm, apo te ngjashme për tre vitet e fundit dhe te dëshmohet me deklarate tatimore apo dokument te ngjashëm te lëshuar nga ATK prej jo më pakë se 4,000,000.00 euro.**
Kërkesa 2. OE duhet të ketë të pakten **300,000.00 euro asete likuide financiare në llogarin bankare, ose të pakten 300,000.00 euro qasje për kredi në dispozicion.**	**Dëshmia 2. Deklarat nga banka që vërteton disponueshmërin e 300,000.00 euro në llogarin bankare të kompanisë apo një vërtetim bankar origjinal, apo me shenime premtuese që konfirmon se kompania mund të merr kredi prej 300,000.00 euro nëse është e nevojshme. Data e deklaratës bankare nuk mund të jetë më heret se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjalë.**
Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Kërkesa 1. OE duhet të ofroj një deklarta me shkrim për realizimin e projektit sipas specifikimeve teknike	**Evidenca 1. OE duhet të paraqesë një deklaratëtë shkruar që është në përputhje të plotë mekërkesat e specifikimeve teknike të detyrueshme.**
Kërkesa 2. OE të jetë i pajisur me dokumentacion sipas kërkesave të ligjit 04 L-161 Për siguri dhe shëndet në punë.	**Evidenca 2. OE duhet të dëshmoj raportin e vlerësimit të rriskut për të gjitha pozitat sipas organogramit dhe organizimit të kompanisë nga një kompani e licencuar nga Ministria e**

	Punës dhe Mirëqenies Sociale.		
Kërkesa 3. OE duhet të ketë stafë profesional si dhe të ketë provoj në shërbimet dhe përgatitje adekuate shkollore. 1. së paku (1) punëtor të kualifikuar për sanitari apo të ngjajshme.	Evidenca 3 OE për piken 1. duhet të dëshmoj stafin me certifikat në sanitari apo të ngjajshme.		
Kërkesa 4. OE duhet të ketë pajisje (vinqi) deri në 25 metra për pastrimin e gjamave të jashtëm në klinikat e QKUK-së të cilat mbrrijnë lartësin deri në 5 kate.	Evidenca 4. OE duhet të dëshmoj për posedimin e pajisjes vinqi me librez të automjetit pajisjs, ose marveshje të notarizuar për marrje të paisjës me qira.		
Kërkesa 5. OE ka për obligim të angazhoi të gjithë puntorët në shërbimet e pastrimit në muajt e fundit në QKUK.	Evidenca 5. Të dëshomohet me deklarat me shkrim nga OE fitues se do ti angazhoj numrin e punëtorve nga stafi actual bazuar në specifikat teknike.		
Kërkesa 6. Operatori ekonomik duhet te sjelle katalogun apo foto me pershkrim detal te mpërbajtjes së produktit për arikullin 1,2,3 dhe 4 te matriali higjenik i cili eshte ne tabelen e dytë të pershkrimit te qmimit konform specifikimeve teknike te pershkruara në aneksin 5 te specifikacioni teknik të DT.	Evidenca 6. Operatori ekonomik duhet te ofroj si dëshmi katalogun apo foto me pershkrim detal te përbajtjes së produktit për arikullin 1,2,3 dhe 4 te matriali higjenik i cili eshte ne tabelen e dytë të pershkrimit te qmimit konform specifikimeve teknike te pershkruara në aneksin 5 te specifikacioni teknik të DT		
Kërkesa 7. Paga bruto e punëtorëve duhet të jetë 402€, e pasqyruar me të gjitha obligimet ligjore sipas ligjit të punës me numër L 03-212 dhe ATK-së	Evidenca 7. Operatori Ekonomik duhet të paraqes një analizë financiare të detajuar me shkrim, si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar për ofertën e dorëzuar duke përfshir pagat e punëtorëve me të gjitha kontributet sipas ligjit të punës dhe ATK-së, pagën e menaxherit dhe dy përgjegjësve, pushimet vjetore, ndërrimet e natës, festat dhevikendet, uniformat, duke perfshir edhe cmimet e matrialeve higjenike dhe		

		antibakteriale qe janë të përcaktuar me sasi në specifikacioni teknik të dosjes së tenderit.		

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(VENDIMI MBI RISHQYRTIM)

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës

Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo
Zyra e Prokurimit

NGA/OD/FROM:		Nexhat Halili - Shefi i Prokurimit të QKUK-së			
TEMA/ SUBJEKAT /SUBJECT:		Vendim i kërkesës për Rishqyrtim			
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	28	Lokacioni: Kucni: Extension:	Prokurimi	Data: Datum: Date:	26.10.2023

Bazuar ne Nenin 108A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe te një kërkesë për Rishqyrtim nga OE, Autoritetit Kontraktues-SHSKUK, e mori ketë:

VENDIM

Kërkesa për Rishqyrtim Refuzohet

Arsyetim

Lidhur me tenderin:“ **Pastrimi i Hapsirave të brendëshme, të Objekteve në QKUK-ë me** ref nr **701-23-10641-2-1-1** dhe nr i brendshëm: **701-23-211-211** me datë: **23.10.2023**,në AK-SHSKUK, është pranuar një kërkesë për rishqyrtim, **e cila refuzohet** me arsyetimin se:

Pretendimi 1.
Kerkesa mbi mundesin teknike dhe profesionale pika 9.1 dhe 9.2

1.Te kerkesa nr.3
AK ka kerkuar që Operatori Ekonomik duhet të ketë një staf profesional si dhe të ketë përvoj në sherbimet adekuate shkollore, së paku një puntorë të kualifikuar për sanitari apo diqka të ngjajshme. Pergjigja nga AK për këtë pyetje ka qenë: referohuni dosjes së tenderit. Në qoftese i referohemi dosjes se tenderit, ashtu siq AK ka rekomanduar: Kjo kërkesë është e panevojshme dhe është në kundërshtim me këtë aktivitet të prokurimit sepse këtu kemi të bëjmë vetëm me pastrimin e siperfaqeve të brendshmë në objeket e QKUK-së dhe askund në dosje të tenderit nuk shkruan se ne do të mirmbajm edhe sanitaritë sepse QKUK-ja i ka puntorët për sanitari dhe punë të tjera, kjo kërkesë është ne kundërshtim me nenin 69 te LPP-se pasi qe vet natyra e këtij aktiviteti te prokurimit është pastrim i hapësirave dhe asnjë pozicion ne paramase te këtij aktiviteti te prokurimit nuk është edhe rregullimi i sanitarisë nëse ato prishen por vetëm pastrimi i tyre. Kjo është
një kërkesë e kundërligjshme te cilën AK duhet ta heq nga DT dhe NJK pasi qe nuk ka te beje fare me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit konform nenit 25.6 te RregulloresNr.01/2022 te KRPP-së ku thuhet: Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.

Përgjigjja e AK për Pretendimin 1 -- Ky pretendim i OE është i pabazuar sepse Autoriteti Kontraktues ka kontrolla nga instutucione te tjera relevante qe meren me kushtet e hixhenës në objektet e QKUK-së (Inspektor sanitar) andaj OE ofertues duhet të ketë së paku një puntorë të kualifikuar për sanitari apo diqka të ngjajshme.

Pretendimi 2.
AK ka kërkuar edhe ISO standrdet si •
1. **Kërkesa 4. OE të jetë i certifikuar me ISO 9001 2015 – Menaxhimi i Cilësisë për shërbimet e Higjienës**

2. Kërkesa 5. OE të jetë i certifikuar me ISO 14001 2015 – Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit për shërbimet e Higjienës
3. Kërkesa 6. OE të jetë i certifikuar me 45001 2018 Sistemi i menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë për shërbimet e pastrimit
Ne mendojme se këto ISO standarte janë të pa nevojshme, e sidomos ISO 9001-2015- Menaxhimi i Cilësis për shërbimet e Hixhienës, ku vet AK nuk ka kërkuar të paktën një menaxher me një përgaditje universitare për menaxhim, por ka kërkuar qe OE duhet të ketë një punëtor të kualifikuar për sanitari apo të ngjashëm, i cili nuk ka të bëjë më kurrëfar menaxhimi në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, pra nuk i përgjigjet natyrës së shërbimit sepse AK ka kërkuar mirëmbajtës të sanitarisë e jo Menaxher për shërbime të pastrimit. Shtrohet pyetja se për qfarë cilësie të menaxhimit bëhet fjalë. Pra ne menojme se kjo kërkesë është në kundershtim me ligjin dhe si e tillë duhet të largohet nga kriteret e përzgjedhjes

Përgjigjja e AK për Pretendimin 2 – Ky pretendim i OE është i pabazuar sepse kemi të bëjme me pastrimin e objekteve ku ndjeshmëria eshte shumë e lartë dhe lidhet direkt edhe me pacientin andaj AK kërkon nga Operatoret ekonomik qe te kenë një Menagjim profesional ku lidhet direktë me sherbimin e cilsisë për shërbimet e higjenës, një Menagjim profesional ku lidhet direktë me mjedisin sepse kemi të bëjm me largimin e mbeturinave të produkteve medicionale, një Menagjim profesional ku lidhet direktë me sigurinë në punë për te gjithë puntorët e angazhuar nga OE sepse kemi të bëjmë me pastrimin e hapësirave me rrezkëshmeri te lartë nga smundjet e ndryshme qe trajtohen pacient neper klinika.

.
Pretendimi 3.
Kërkesa 5. OE ka për obligim të angazhoi të gjithë puntorët në shërbimet e pastrimit në muajt e fundit në QKUK. Kjo kërkesë është diskriminuese sipas neni 7 LPP-së pasi që AK nuk ka të drejtë të obligoj (imponoj) OE marrjen e këtyre punëtorëve edhe kjo kërkesë është e pa nëvojshme dhe duhet të largohet.

Përgjigjja e AK për Pretendimin 3- Ky pretendim i OE është i pabazuar sepse te gjithë puntorët e pastrimit kan qenë ma heret pjesë e QKUK-së dhe ne momentin e kalimit të shërbimit të pastrimit te operatoret privat ne te gjitha kontratat e mëhershme me operator te ndryshëm qe kan qen të kontraktuar nga QKUK-ja kan qen te angazhuar.

Pretendimi 4.
Edhe për këtë kërkesë AK nuk ka dhënë sqarime në pyetjet e parashtruara për sqarime shtesë. Pergjigja e AK ka qenë: referohuni dosjes së tenderit. Te pika 9.1 dhe 9.2 te kerkesa per kapacitete teknike dhe profesionale njoftimi per kontrat
Pse është hequr kërkesa dhe dëshmia, te cilat po i paraqesim ne vijim :

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1. Kërkesa 1. Operatori Ekonomik ofertues duhetë ofrojë një listë te kontratave te natyrës sengjashme (lëmin e pastrimit) te përfunduar me sukses ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë.	Evidenca 1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi një listë te kontratave te natyrës se ngjashme (lëmin e pastrimit) te përfunduar me sukses ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te percjellur me referenca apo raporte te pranimit. Lista duhet ti permbaje te dhenat si Daten e nenshkrimit, Daten e perfundimit, Titullin e Kontrates, Autoritetin Kontraktues, Vleren e projektit.

AK e ka larguar këtë kërkesë në NJK, në kundërshtim me LPP-në. Pra AK duhet të veproj konform LPP-se pika 4 dhe 4.2 e Nenit 69 tek. Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale ku thuhet se:

4. Ne procedurat që shpien ne dhënien e kontrates publike ne te cilen perfshihet sigurimi i sherbimeve, autoriteti kontraktues mund te kërkoje nga operatorët ekonomik te sigurojne te dhenat me te cilat deshmohet aftësia e tyre per sigurimin e këtyre sherbimeve: ne veçanti, te dhënat mund te kerkohen lidhur me shkallitësite, efikasitetin, kapacitetin, pervojen dhe besueshmërinë. Te dhenat përkitazi me aftësite teknike te operatoreve ekonomik mund te parashtrohen përmes nje ose me shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qellimit te sherbimeve që duhet te furnizohen:

4.2 listen me te cilën saktësohen te gjitha kontratat kryesore te rendësishme te sherbimeve te realizuara ne periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktesuar llojin e sherbimeve të perfshira, shumen e kontrates, daten dhe pranuesin: (i) kur sherbimet janë siguruar per autoritetin publik ne Kosovë ose ne vendin tjetër, si deshmi per këto sigurim te sherbimeve do te sherbeje kopja e certifikatës (certifikatave) perkatese të lëshuar ose bashkëvenshkrtura nga autoriteti i tillë publik: (ii) kur sherbimet janë siguruar per blersin privat, deshmi per këtë sigurim te sherbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti te nënshkruar nga blersi dhe evidentimi i sigurimit te tillë:

ky veprim i AK është edhe ne kundërshtim me nenin 25.5 te Rregullores Nr.01/2022 te KRPP-së ku thuhet:

"Kriteret e përzgjedhjes do të specifikohen qartë ne njoftimin per kontratë dhe në dosje te tenderit".

Pra AK është dashur qe te kërkoj një liste te kontratave sipas pikës 4.2 te nenit 69 te LPP-se pasi qe është patjetër e nevojshme qe te dihet se ku janë kryer ato pastrime te brendshme, kur kane filluar dhe kur janë kryer apo nuk janë kryer me sukses etj.

Pra AK po bie ne kundërshtim me vetveten pasi qe vet AK ka kërkuar qarkullim ne vlere prej katër milion euro ne lëmin e pastrimit te brendshëm kurse nuk ka kërkuar asnjë dëshmi se si mund ta vërtetoj nje OE pjesëmarrës ne këtë procedure qe ai qarkullim prej katër milion euro qe e prezanton ka rrjedh nga lemia e pastrimit te brendshëm.

Ky është kriteri kryesor i cili dëshmon per kapacitete teknike dhe profesionale te OE. Keni kerkuar qarkullim prej **4,000,000.00 euro** ne lemin e pastrimit te brendshem dhe me qka te deshmohet. Ky qarkullim nuk mund te deshmohet (vertetohet) me vertetim tatimor apo me deklarat tatimore nga ATK. kemi bere pyetje ATK-se lidhur me kete qeshtje te qarkullimit , vertetim tatimor ose deklarat tatimore. Pergjigjien gojore qe e kemi pranuar nga ATK-ja. Ka qene sepse ATK nuk leshon kurrfar vertetimi tatimor me qarkullim per periudha te caktuara siq keni kerkuar ne dosje te tenderit, mirepo leshon vetem deklarat tatimore vjetore ose mujore per qarkullim per ate periudhe per tri vitet e fundit ashtu siq eshte kerkuar ne DT por kurrsesi nuk e specifikon se qarkullimi eshte ne lemin e pastrimit te brendshem apo ndonje lemi tjeter. Por, ky qarkullim vertetohet vetem me kontrata te realizuara (perfunduara) duke ju bashkangjitur referencat ose raportet e punes, shumen e kontrates, daten e fillimit dhe te mbarimit te kontrates ashtu siq e parasheh ligji dhe ashtu siq e keni kerkuar ne njoftimin per kontrat. Pra, me heqjen e kesaj kerkese duket qarte se ju si AK jeni te perceaktuar per favorizimin e nje kompanie per te cilen jemi ne dijeni edhe ne si OE.

Ne vend se te vendosni kritere komform peshes se ketij atktiviteti te prokurimit ne vlere mbi **7,000,000.00 euro**, ju si AK keni vendosur kritere diskriminuese dhe favorizuese, e themi me plote pergjegjesi Kritere Favorizuese eshte se e keni hequr ne njoftim per kontrata kerkesen mbi mundesin teknike dhe profesionale. Mos vendosja e kësaj kërkese iu jep mundësi edhe shumë operatoreve ekonomik të tjere të konkurrojnë pa kurrfarë përvoje në këtë proces, pra iu jepet mundësia që të konkurrojnë edhe kompanit e ndërtimit të rrugëve, pastrimit kimik, pasrimit te rrugeve, kompanive të ndërtimit të ndërtesave dhe shume kompani të tjera , të cilat nuk janë të profesionalizuara për këtë lëmi.

Përgjigjja e AK për Pretendimin 4- Ky pretendim i OE është i pabazuar sepse AK mendon se dëshmia më e mirë që prezentohet nga një Operator ekonomik profesional në lëmin e pastrimit është qarkullim prej 4,000,000.00 euro ne lemin e pastrimit te brendshem. Ky qarkullim mund te deshmohet (vertetohet) me vertetim tatimor apo me deklarat tatimore nga ATK

Përfundim: Në bazë të arsyeve të lartcekura Autoriteti Kontraktuesi QKUK-së e refuzon këtë kërkesë për rishqyrtim si të **pa bazuar.**

Për ne të gjithë Operatoret Ekonomik janë të rendësishëm dhe të barabartë.

Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë pranë OSHP-së.

Me respekt

Nexhat Halili

Shef i prokurimit të QKUK-së

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **"KRASNIQI"SH.P.K.**

Pretendimi n1

Pretendimet rkeysrore ankimore sipas ankesës 848/23 kantë të bëjnë me kërkesat e AK-së të vendosura në dosje të tenderit për të cilat OE pretendon se janë diskriominuese dhe të panevojshme.

Pas analizimit të ankesës, dosjes së tenderit dhe vendimit të AK-së në kërkesë për rishqyrtim, vlerësojmë se të gjitha kërkesat siq janë kërkesa për një punëtor të kualifikuar për sanitari, kërkesat për ISO standarde, Janë kërkesa relevante dhe proporcionale nëraportme lëndënekontratës përkatëse.

Këto kërkesa sipas mendimit tonë janë dëshmmi mbi angazhimin e OE-ve për të siguruar një organizim dhe menaxhim më të mirë të kompanisë për shërbimet të cilat ata I ofrojnë, në veqanti në rastin konkret kur kemi të bëjmë me pastrimin e hapësirave me rrezikshmëri të lartë.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Pretendimi nr.2

Kërkesa për dëshmi nga ATK për qarkullimin financiar për të cilën OE pretendon se është e pamjaftueshme për të dëshmuar përvojën e OE-ve, konsiderojmë se është e drejtë e AK-së se cilat dëshmi të parapara në LPP zgjedh ti vendos në dosje të tenderit.

Në rastin konkret AK ka zgjedhur të aplikoj kërkesat në pajtim me nenin 68 par.1, nënpar.1.5 të LPP-së, andaj konsiderojmë se pretendimi ankimorë është I pabazuar

Pretendimi nr.3

OE ankues pretendon se kërkesa e AK-së OE se ka për obligim të angazhoi të gjithë punëtoret në shërbimet e pastrimit në muajt e fundit në QKUK. Kjo kërkesë është diskriminuese sipas neni 7 LPP-së pasi që AK nuk ka të drejtë të obligoj (imponoj) OE marrjen e këtyre punëtorëve. Pra edhe kjo kërkesë është e pa nëvojshme dhe duhet të largohet.

Ky pretendim ankimorë është vlerësojmë se është I bazuar, pasi sipas nenit 7 , par.5 të LPP-së AK nuk ka të drejtë të kërkoj të punësohen persona të veçantë.

Neni 7 par.5:

"***Autoriteti kontraktuesnukdotëkërkojëngaoperatori ekonomikqëtë(i)punësojë****osepërdorë, osetë mospunësojëosepërdorë****,ndonjëperson*** *osendërmarrje****të veçantëpërekzekutimine çfarëdoaspektitënjëkontratepublike****,ose(ii)qëtëfurnizojëosesigurojë,ose****tëmosfurnizojë ose sigurojë,produkte ose shërbimetë cilat rrjedhinnganjëperson****,ndërmarrjeose rajoni veçantëgjeografik*".

Ne e kuptojmë se qëllimi I AK-së është të sigurohet se punonjësve aktual të nmos ju rrezikohet vendi I punës, megjithatë kërkesa është e kundërligjshme, dhe një gjë e tillë eventualisht mund të arrihet vetëm me mirëkuptim në mes të OE që realizon kontratën dhe AK-së.

Bazuar në këto që u cekën më lar vlerësojmë se pretendimi ankimorë është I bazuar dhe kjo kërkesë duhet të heket.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjeserisht si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **"KRASNIQI"SH.P.K.**

Ilir Halili